



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E LIPJANIT
REPUBLIKA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: 16.04 20 25		
Priljeno:		
Njësia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-052/01-86226		



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT

Raport nga mbledhja e parë publike e thirrur nga kryetari i komunës në qershor të vitit 2025

Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-016/0163314, e datës 26.12.2024 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në komunë, Komuna e Lipjanit harton procesverbal nga mbledhja e parë publike e thirrur nga kryetari i komunës për periudhën janar-qershor 2025 i cili është mbajtur me datën 20.06.2025, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 10:00. Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Komuna është e obliguar të mbaj dy tubime me publikun, njërin në gjashtëmujorit e parë të vitit fiskal dhe tjetrin në fundvit.

Ecunia e Procesit

Zyrtari përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e konsultimeve publike në Komunën e Lipjanit ka bërë me kohë lajmërimin dhe ka publikuar njoftimin në ueb faqe të Komunës, në dy gjuhët zyrtare, dy javë para mbajtjes, sipas ligjit për Vetëqeverisje dhe rregullatives tjetër ligjore të cilat janë në fuqi.

<https://lipjan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/202505281028208655.pdf>

Po ashtu njoftimi është vendosur edhe në hyrje të objektit të komunës si dhe në vendet e tjera më të frekuentuara nga ana e qytetarëve.

Pas hartimit të këtij raporti dhe dhënies së protokollit të brendshëm, i njëjti do t'i dërgohet të gjitha drejtorive dhe njësive komunale.

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/kontribuesve
1.Publikimi në ueb faqe	14 ditë pune	40
2. Konsultimet me shkrim/në mënyrë elektronike	14 ditë pune	40

Në këtë tubim publik kanë marrë pjesë **40** pjesëmarrës, prej tyre **12** femra dhe **28** meshkuj.

Takimi i cili është mbajtur **20.06.2025** duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit Komunal ku kishte karakterin informues për të gjithë pjesëmarrësit. Përfaqësuesit e komunës kanë njoftuar për aktivitetet komunale, të arriturat dhe vështirësitë, për synimet dhe investimet kapitale gjatë periudhes për të cilën është thirrur takimi, ndërsa të pranishmit paten rastin të bëjnë pyetje dhe të japin propozime lidhur me realizimin e projekteve të planifikuara si dhe për çështje të tjera që janë në interes të tyre dhe gjithë qytetarëve të tjerë.

Për të folur rreth aktiviteteteve të Komunës, për planet dhe sfidat, fjala kryesore i takoi kryetarit të komunës, Imri Ahmeti.

Në prani të drejtorëve të Drejtorateve komunale, përfaqësuesve të Këshillave Lokal përfaqësuesve të shoqërisë civile dhe shumë qytetarëve tjerë, mbledhjen e hapi kryetari i Komunës, Imri Ahmeti ku takimin e filloi duke i njoftuar të pranishmit për punën gjatë periudhes janar-dhjetor 2025 të qeverisjes lokale ku bashkarisht kanë diskutuar për të gjitha projektet, të arriturat dhe sfidat gjatë kësaj periudhe.



Kryetari Imri Ahmeti në fillim të këtij takimi është shprehur i kënaqur me dinamiken e investimeve kapitale e cila po shënon një rritje në bazë të planifikimit, ku theksoi se aktualisht janë duke u zhvilluar në teren shumë projekte investime vetanake nga komuna dhe projekte të tjera së bashku me partner.

Kryetari Imri Ahmeti, ka vazhduar duke thënë se projekte të shumta kapitale janë proces të publikimit, vlerësimit dhe lidhjes së kontratave dhe shumë shpejtë do të filloj implementimi i tyre.

Gjatë takimit, Kryetari Ahmeti vlerësoi trendin pozitiv në realizimin e të hyrave vetanake, ku deri më tani janë realizuar 56.40% e planifikimit vjetor. Veçanërisht u theksua realizimi i tatimit në pronë, i cili ka arritur në 53.52%, duke shënuar një rritje prej 19.34% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

“Realizimi i përgjithshëm i të hyrave vetanake është rritur për 25% krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2024, që dëshmon për një performancë të qëndrueshme dhe menaxhim efektiv të buxhetit komunal,” tha Kryetari z. Imri Ahmeti.

Sa i përket projekteve kapitale, aktualisht janë në proces disa projekte, ku një pjesë e tyre është duke u zbatuar në terren, ndërsa të tjerat ndodhen në fazat e procedurave të tenderimit dhe përzgjedhjes së operatorëve, me pritshmëri që shumë shpejt të fillojnë punimet.





Kryetari Ahmeti theksoi se Komuna e Lipjanit, falë qeverisjes transparente, është shpallur fituese e Grantit të Performancës nga DEMOS, përmes të cilit ka siguruar mjete shtesë për projekte të reja. Këto projekte tashmë janë në fazën e tenderimit dhe pritet që së shpejti të nisin zbatimin në terren.

Gjithashtu ai potencoi se përveç investimeve në infrastrukturë, prioritet i veçantë do t'u kushtohet edhe sektorëve të arsimit, shëndetësisë, bujqësisë, sportit, kulturës dhe rinisë, për të cilët janë realizuar projekte konkrete dhe do të vazhdohet me mbështetje të vazhdueshme në funksion të përmirësimit të jetës së qytetarëve.

Më tutje kryetari Imri Ahmeti ka shpalosur edhe disa nga të arriturat e ekzekutivit përgjatë kësaj periudhe raportuese duke theksuar se në vazhdimësi jemi angazhuar që të gjithë qytetarëve lipjanas t'iu ofrojmë kushte dhe shërbime sa më cilësore. Jam i kënaqur me rezultatet e arritura nga Komuna e Lipjanit në zbatim të ligjit dhe transparencës e llogaridhënies, ka bërë që Lipjani të renditet si komuna e parë në nivel vendi në nga KDI.

Ai po ashtu tha se kur jemi të vlerësimet i gëzohemi faktit që Komuna e Lipjanit në pas çdo matje që ju bëhet komunave është në krye të listave në nivel vendi.

Kryetari Imri Ahmeti po ashtu ka njoftuar të pranishmit se tani jemi në kohen e hartimit të Kornizës Buxhetore e cila gjatë vitit mund edhe të pesojë ndryshime, qoftë nga rishikimi i buxhetit, qoftë nga redistribinimi, qoftë edhe nga tejkalimet e të hyrave, qoftë edhe nga donacionet dhe grantet që marrim gjatë vitit, por që kontributi juaj përmes dëgjimeve buxhetore për KAB që po zhvillohen është i jashtëzakonisht i duhur për lokalitetet dhe vendbanimet nga ju vini në mënyrë që t'i zgjedhim bashkarisht problemet e ndryshme kolektive por edhe ti realizojmë projektet më prioritare për vendin tuaj.

Kryetari Ahmeti, ftoi qytetarët që të jenë sa më bashkëpunues sa më aktiv që nëpërmjet sugjerimeve, vërejtjeve dhe kërkesave të bëhen pjesë e pandashme e ndikimit në përmirësimin e jetës së gjithë qytetarëve të Komunës së Lipjanit, në të njejtën kohë ai i ka falënderuar ata për kontributin e vazhdueshëm që po japin në lokalitet e tyre.

Në përmbyllje të takimit, Kryetari Ahmeti falënderoi të gjithë pjesëmarrësit dhe ritheksoi rëndësinë e komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët si pjesë thelbësore e qeverisjes së hapur, gjithëpërfshirëse dhe transparente në shërbim të qytetarëve.

Qytetarët prezent në këtë takim publik, kanë shprehur falënderime për Kryetarin Ahmeti, për angazhimin në kryerjen e punëve të shumta që po bënë për të përmirësuar jetën e qytetarëve të Komunës së Lipjanit si dhe paraqiten kërkesat për investime kapitale në të ardhmen krahas lokaliteteve të tyre e të cilat janë më me prioritet për ta.

Temat e Konsultimit	Komentet	Kush ka komentuar	Përgjigje në pyetjet/komentet e parashtruara	Komente (komentimi për pranimin pjesërisht dhe mos pranimit të komenteve është i detyrueshëm)
Raport nga tubimi i parë publik i kryetarit në qershor të vitit 2025	Ka ka kërkuar përgjigje për qështjen të cilën e ka ngritur që disa herë që ka të bëjë me asfaltimin e rrugicës “ Milazim Petrova”, ku ne kemi bërë një kërkesë së bashku me nënshkrimin e banorëve për asfaltimin e asaj rrugice mirëpo deri më tani nuk ka asgjë. A ka diçka pozitive rreth kësaj çështje ose jo?	Zymer Ahmeti, përfaqësues i lagjes se Akllapit	Kryetari Imri Ahmeti: tha se sa i perkat asaj rrugice ju kam premtuar që pas pelqimit nga ana e juaj do te asfaltohet dhe shumë shpejt do të procedohet nga drejtoria e prokurimit.	Komenti u pranua Plotësisht
Raport nga tubimi i parë publik i kryetarit në qershor të vitit 2025	Ka kërkuar të dijë rreth rrugës “ Milazim Petrova”, se kur do të asfaltohen sepse edhe fëmijët po detyrohen te shkojnë në shkolle neper baltë.	Bujar Qeriqi,	Kryetari Imri Ahmeti: tha se sa i perkat asaj rrugice ju kam premtuar që pas pelqimit nga ana e juaj do te asfaltohet dhe shumë shpejt do të procedohet nga drejtoria e prokurimit. Ndërsa sa i përket nxënësve ne	Komenti u pranua Plotësisht


			nxënësit i bartim me autobus nga të gjitha fshatrat e Lipjanit por dhe nga qyteti deri në shkollë dhe anasjelltas.	
Raport nga tubimi i parë publik i kryetarit në qershor të vitit 2025	tha se e falënderojmë kryetarin e komunës për punët e mira që janë bërë në fshatin Shalë, por kemi dhe disa kërkesa të vazhdoj rruga deri te Memoriali, pastaj vendosja e dy bus stacioneve te fshat, dhe disa çështje te tjera.	Xhyla Korpuzi, përfaqësues e fshatit Shalë	Kryetari Imri Ahmeti: ka thënë se në Shalë vitet e fundit janë bërë insvetime dhe janë planifikuar edhe asfaltime të rrugicave por edhe do i marrim parasysh edhe kërkesat e tjera që vin nga banorët e Shalës në mënyrë që ato të planifikohen me kohë.	Komenti u pranua Plotësisht
Raport nga tubimi i parë publik i kryetarit në qershor të vitit 2025	Ka thënë se ne fshatin Grackë ka nevojë për investime së pari vazhdimi i ndriçimit publik në disa rrugica, riparimi i rrugës kryesore etj.	Milaim Xhema përfaqësues i fshatit Grack,	Kryetari Imri Ahmeti: Në Grackë janë bërë investime, ka investime shtesë që janë planifikuar dhe buxhetuar për Gracken por do të planifikohen edhe kërkesa tjera që dalin nga banorët duke u nisur nga ato më prioritare.	Komenti u pranua Plotësisht
Raport nga tubimi i parë publik i kryetarit në qershor të vitit 2025	Ka thënë se ka nevojë për asfaltimin e rrugicave në Brus2 dhe Peshter 2, po ashtu edhe ndriçimi publik ne fshat.	Engjell Gashi, përfaqësues i fshatit Brus	Kryetari Imri Ahmeti: tha se shumë shpejt do të nënshkruhet kontrata e ndriçimit publik po ashtu do të planifikojmë edhe projekte tjera për këtë fshat.	Komenti u pranua Plotësisht
Raport nga tubimi i parë publik i kryetarit në qershor të vitit 2025	tha se në fshatin tonë janë bërë disa investime, por ka nevojë edhe për disa investime te tjera se pari te shkolla, pastaj	Ramadan Sylejamni, përfaqësues i fshatit Leletiq	Kryetari Imri Ahmeti: Në Leletiq janë bërë investime, ka investime shtesë që janë planifikuar dhe buxhetuar për Leltiqin por do të palnifikohen	Komenti u pranua Plotësisht

	rregullimi i një ure etj.		edhe kërkesa tjera që dalin nga banorët duke u nisur nga ato më prioritare.	
Raport nga tubimi i parë publik i kryetarit në qershor të vitit 2025	tha se në fshatin Mirenë janë bërë investime, por kanë mbet në gjysmë edhe zgjerimi i rrjetit të kanalizimit me një lagje, pastaj asfaltimin e disa rrugicave.	Qerim Fazliu, përfaqësues i fshatit Mirenë,	Kryetari Imri Ahmeti: Sa i përket kanalizimit në Mirenë ka mbet vetëm një lagje për shkak të problemeve që kemi aty aty, ndërsa disa projekte tjera janë planifikuar dhe do të marrim në konsideratë edhe kërkesat e tjera që dalin nga banorët.	Komenti u pranua Plotësisht
Raport nga tubimi i parë publik i kryetarit në qershor të vitit 2025	tha se në fshatin Dobrajë janë bërë shumë investime ashtu siç janë bërë edhe në fshatrat tjera që nuk janë bërë që disa vite. Dhe Lipjani me fshatra ka ndryshuar me të madhe për të mirë.	Skender Gashi, përfaqësues i fshatit Dobrajë	Kryetari Imri Ahmeti: ka potencuar se Komuna e Lipjanit do të vazhdoj të investoj në secilin fshat duke u nisur nga prioritetet.	Komenti u pranua Plotësisht:
Raport nga tubimi i parë publik i kryetarit në qershor të vitit 2025	tha se ju falënderoj për punët e mira që janë bërë në fshatin Kleqkë, ku së fundi është bërë edhe asfaltimi i disa rrugicave dhe kisha kërku që në secilin venbanim të vazhdoni me punë të tilla	Milazim Shala,	Kryetari Imri Ahmeti: ka potencuar se Komuna e Lipjanit do të vazhdoj të investoj në secilin fshat duke u nisur nga prioritetet.	Komenti u pranua Plotësisht

Raport nga tubimi i parë publik i kryetarit në qershor të vitit 2025	tha se janë bërë investime të mëdha në përgjithsi në komunën e Lipjanit, por kam një kërkesë për rregullimin e shtyllave të cilat bartin emrat e rrugëve.	Kamer Podrimaqaku	Kryetari Imri Ahmeti: tha që jemi në process të emërimit të rrugëve dhe pastaj do i vendosim tabelat për emërtimin e rrugëve.	Komenti u pranua Plotësisht
Raport nga tubimi i parë publik i kryetarit në qershor të vitit 2025	tha se në komunën e Lipjani janë bërë investime në secilin fshat, mirëpo ka nevojë për rritje të subvencioneve te klubet sportive pasi që rinia po ikin dhe duhet me shumë të investohet në sport aty ku është rinia.	Imri Lacaj,	Kryetari Imri Ahmeti: Sa i perkat rritjes se subvencioneve ne kemi bërë përpjekje që të rriten nga viti në vit dhe prap të rriten sa na lejojnë mjetet buxhetore sepse kemi dhe bujqësinë dhe dikastere tjera.	Komenti u pranua Plotësisht
Raport nga tubimi i parë publik i kryetarit në qershor të vitit 2025	tha se në komunën e Lipjanit janë bërë shumë investime mirëpo ka nevojë për mirëmbajtje te pronës publike pasi qe është ne gjendje jo të mirë.	Bardhyl Ibrahimi,	Kryetari Imri Ahmeti: ka thënë se për momentin ka skaduar kontrata e mirëmbajtjes dhe jemi afër nënshkrimit të kontrates së re për mirëmbajtjen e ndriçimit publik po ashtu edhe të varrezave dhe pronës publike.	Komenti u pranua Plotësisht

Shtojcë: lista e pjesëmarrësve

Udhëheqëse e Sektorit për Komunikim me Publikun


Bukurie Zejnullahu -Jashari

Lipjan, 16.07.2025



KOMUNA E LIPJANIT

REGJISTRI I PREZENCËS SË QYTETARËVE TË KOMUNËS SË
LIPJANIT, NË DËGJIMIN PUBLIK TË MBAJTUR ME 20.06.2026
NË SALLËN E KUVENDIT ME FILLIM NË ORA 10,⁰⁰

Nr. Ren.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Nënshkrimi
1.	Kamran Podrimipi	Lipjan	
2	Shkender Gashi	Lipjan, e rehat	
3	Mustafë Rexhepi	Gjethin e Ciprës	
4	Deris - Drita	Lipjan	
5	Behar Derisi	Lipjan	
6	Sinur Gërg	Krajan	
7	Milaim Shala	Krajan	
8	Mehdi Avdyli	Bregu i Zi	
9	Arlinda Amerilolu	Lipjan	
10	Rinesa Baktiri	Lipjan	
11.	Emine Deliu	Lipjan	
12	VLOKA KRASHNIG	LIPJAN	
13	Kimete Jasharia	OSCE	
14	LIRIA DRAGATINA	BUJAN	
15	Behar Krasnig	Shkupushë	
16	Gazurr Heterme	Lipjan	
17.	Islam Kaleshi	Dellopesh	
18	Imri Shabani	POTUROC	
19	NUMETE DUTU	SHUNI	
20	Zola Jidani	Majur	
21	Shkender Kaleshi	KRAJE	
22	BARONJL IBRAHIM	GLLOQOV	
23	IMRI LACAJ	KRAISHTË	
24	Aslan Thaci	KALLË	
25	Mehmeti Arifi	QAGRAKLICAJ	
26	Njazi SLAMNICK	TOPLIQAN	
27	GENA GASNI	BRUS	
28	MURAT GELBISHI	SILUVI	
29	Mustafë Ahmeti	Lipjan	
30	Art Krasnig - TAHIR	Lipjan	
31	SHKENDER BEQIRI	LAKHJA AKLIAPET	
32	ISMAIL REJNULLOJ	KAPULLE	
33	FORM BUTYRI	QYLLQ	
34	MURAT GYLLAN	KIRKO	
35	ALBAN DALLAN	LIPJAN	
37	Fatime Sinani	Resinoc	

38	Xhaya Koppur	Shoko	
39	Ala Kaimi Xhema	Gumbe eyetel	
40	ARREZHA HETEMI	LIPJAN	
	Momta allustafa	Lipjan	